DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracija
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-160/2
Data Datum Date 09-03-2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Shpend Ahmeti,** Kryetar i Komunës së Prishtinës<br>**Agim Kuleta,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Emilija Redžepi,** Ministre e MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj,** Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë:<br>21.02.2020<br>Nr.020-160 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës | |
| Lloji i aktit: | □ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 01-464/01-33127/20 për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon (Sadik) Topanica |
| I miratuar më datë: 10.02.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 12.02.2020 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 020-160/2
-01-
Data / Datum / Date 09-03-2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Shpend Ahmeti,** gradonačelnik opštine Priština<br>**Agim Kuleta,** predsedavajući Skupštine opštine Priština | |
| Cc: | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini | |
| Preko: | **Emilija Redžepi,** ministarka MALSa<br>**Rozafa Ukimeraj,** generalna sekretarka MALS-a | |
| Od: | **Venera Çerkini,** rukovodilac Pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS | Dana: 21.02.2020.<br>Br. 020-160 |
| Odgovorni službenici:<br>1. Potvrđeno od:<br><br>2. Izrađeno od: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za nadgledanje opština<br><br>Vjosa Ahmetaj, službenica za nadgledanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta Opštine Priština | |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, Pravnom odeljenju i nadgledanje opština Ministarstva za administraciju lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka Skupštine opštine br.01-464/01-33127/20 za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha i Sylejmon (Sadik) Topanica |
| Usvojena dana: 10.02.2020. godine. |
| Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 12.02.2020. godine. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta ***u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi*** i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe nenit 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 26.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2020, merr këtë


...ZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration
Datum / Date 12.02.2020
| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
| --- | --- | --- | --- |
| 01 | 020 | 160 | |


**V E N D I M**

I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton Topanica. Ismit (Avdi) Shabani. Sabit (Avdi) Shabani . Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon ( Sadik ) Topanica.

II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 04534-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-04534-0, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës nr. 04580-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-04580-0, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 004604-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-004604-2, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës 004603-2 , Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-004603-2, Zona kadastrake Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës nr. 004608-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-004608-2, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, pjesë e parcelës 004609-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71814059-004609-2, Zona kadastrale Topëhane, Prishtinë , pjesë e parcelës nr. 004610-4, Certifikata e pronësisë, nr. P-71814059-004610-4, Zona kadastrale Tophane, Prishtinë, në pronësi të Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani. Sabit (Avdi) Shabani , Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon ( Sadik ) Topanica.

III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Tophane" në Prishtinë.

IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.

V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-464/01-33127/20, më 10.02.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Na osnovu odredbe člana 12, stav 12.2, tačka **d**, Zakona br.03/L-040, o lokalnoj samoupravi ("Službeni List Republike Kosova" br. 28/15, juni 2008), član 24, stav1,2 , i člana 25, stav 1, 2 i člana 6 Zakona br. 06/L-092, o davanju na korišćenje i izmenu nepokretne imovine Opštine ("Službeni List Republike Kosova" br. 11/03 april 2020), član 33.2, slovo **a** i člana 34.1, slovo **d** Statuta Opštine Priština, 01. br. 110-391, dana 25.02.2010, Skupština Opštine Priština, na održanom sastanku dana 10.02.2020 donosi sledeću

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave I Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 12.02.2020

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| -VI | 020 | 160 | |

## ODLUKA

I. **USVAJA SE** predlog Predsednika Opštine za izmenu nepokretne imovine Opštine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha i Sylejmon ( Sadik ) Topanica.

II. Nepokretna imovina Opštine koja će se dati za izmenu ima ove karakteristike: deo katastarske parcele br. 04534-0, certifikat imovine, br. P-71914059-04534-0, Katastarska Zona Tophane, Priština, deo parcele br. 04580-0, certifikat imovine, br. P-71914059-04580-0, Katastarska Zona Tophane, Priština, a nepokretna imovina koja se oduzima od nepokretne imovine, je deo katastarske parcele br. P-71914059-004604-2, Katastarska Zona Tophane, Priština, deo parcele 004603-2 , Certifikat imovine, br. P-71914059-004603-2, Katastarska Zona Tophane, Priština, deo parcele br. 004608-2, Certifikat imovine, br. P-71914059-004608-2, Katastarska Zona Tophane, Priština, deo parcele 004609-2, Certifikat imovine, br. P-71814059-004609-2, Katastarska Zona Tophane, Priština, deo parcele br. 004610-4, Certifikat imovine, br. P-71814059-004610-4, Katastarska Zona Tophane, Priština, u vlasništvu Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha i Sylejmon ( Sadik ) Topanica.

III. Izmena nepokretne imovine je izvršena zato što ne postoje druge opštinske pogodne parcele za realizaciju regulativnog Plana "Tophane" u Prištini.

IV. Pre javnog objavljivanja odluke, biće izvršena kvalifikovana procena tržišne vrednosti nepokretne imovine Opštine i procena privatne svojine, gde će se odrediti tacne površine za izmenu.

V. Način i uslovi razmene nepokretne imovine biće određeni ugovorom, koja se vezuje i potpisuje između Predsednika Opštine i vlasnika katastarske parcele koja će se izmeniti.

VI. Nepokretne imovine opštine koja će se izmeniti, opisane u tačku II ove odluke, treba evidentirati u katastarskim knjigama Opštine.

VII. Za sprovođenje ove odluke stara se: Predsednik Opštine, Direkcija za Imovinu i Direkcija za Katastar Opštine Prištine.

VIII. Sastavni deo ove odluke su:

- grafičke skice
- kopija plana i
- Certifikat katastarske jedinice

IX. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u kancelariji protokola Ministarstva Administracije i Lokalne Vlasti i objavi na službenim jezicima na veb-stranici Opštine.

**SKUPŠTINA OPŠTINA PRIŠTINA**
**01-464/01-33127/20, dana 10.02.2020**

**PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE**
**Agim Kuleta**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
Kryetari i Komunës
01. nr.___________, më________

Në bazë të dispozitave të nenit 58, shkronja **h** e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019) dhe të nenit 52, shkronja **h** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, më _________, i

**P R O P O Z O J**

**I.** Kuvendit të Komunës, miratimin e Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani, Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon ( Sadik ) Topanica.

**II.** Propozimi i cekur në pikën I të këtij propozimi, nënkupton këmbimin e:

1. Sipërfaqja prej 51 m$^2$, pjesë e parcelës kadastrale nr. 4534-0 dhe sipërfaqja prej 155 m$^2$, pjesë e parcelës kadastrale nr. 4580-0, PSH, rrugë, KK Prishtinë, ZK Prishtinë, me:
2. Pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani ,Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon ( Sadik ) Topanica., me sipërfaqe prej 206 m$^2$, pjesë e parcelave kadastrale nr. 4604-2, 4603-2, 4608-2, 4609-2 dhe 4610-4, Zona kadastrale Prishtinë.

**III.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.

**IV.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të këtyre parcelave do të rregullohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesve të parcelave të parapara për t'u këmbyer.

**V.** Pjesë përbërëse e këtij propozimi është edhe skica gjeodezike.

**VI.** Ky propozim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

## Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-79207/19, dt. 04.11.2019, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesëve të parcelave kadastrale nr. 4534-0 dhe 4580-0, në pronësi PSH, rrugë, KK Prishtinë, me pjesët e parcelave nr. 4604-2, 4603-2, 4608-2, 4609-2 dhe 4610-4, me sipërfaqe prej 206 m$^2$, ZK Prishtinë, në pronësi të pronarëve Arton Topanica, Ismit (Avdi) Shabani, Sabit (Avdi) Shabani ,Adem (Shaban) Berisha dhe Sylejmon ( Sadik ) Topanica, të cilat gjendet në kuadër të Planit rregullues "Tophane", në Prishtinë.
Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Tophane ", të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01. nr. 035-579, dt. 22.11.2005, me destinim "zonë me destinim të përzier", plotësuar me Vendimin për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit rregullues urban "Tophane", 01. nr. 35-374, dt. 03.04.2008, si dhe në Planin Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, me destinim "ndërtim i lartë i përzier", parcelat nr. 4534-0 dhe 4580-0, shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa parcelat nr. 4604-2, 4603-2, 4608-2, 4609-2 dhe 4610-4, shtrihen në infrastrukturë rrugore të planifikuar.
Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), pasi që Komuna nuk ka pronë të veten për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij Propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

**Iu dërgohet:**
- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

Kryetari i Komunës

_______________

Shpend Ahmeti

01-591

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-03 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, si dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-79207/19 dt. 04.04.2019 për rihapje të procedurës së lëndës 05 nr. 350/02-0212348/18 dt. 30.08.2018, të pronarëve Arton, Veton, Sylejmon Topanica, Adem Berisha, Ismit Shabani, Sabit Shabani nga Prishtina, me investitor ntp "Albi-Moni" me seli në Podujeve dhe me nr. unik identifikues të biznesit 810428038 dhe me pronar Ismajl Aliu nga Podujeva, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore dhe afariste- Ndërtesa "2", në lagjen "Tophane", në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 04.11.2019, merr këtë:

# VENDIM
## PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** pronarëve Arton, Veton, Sylejmon Topanica, Adem Berisha, Ismit Shabani, Sabit Shabani nga Prishtina, me investitor ntp "Albi-Moni" me seli në Podujeve dhe me nr. unik identifikues të biznesit 810428038 dhe me pronar Ismajl Aliu nga Podujeva, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-79207/19 dt. 04.04.2019 për rihapje të procedurës së lëndës 05 nr. 350/02-0212348/18 dt. 30.08.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore dhe afariste- Ndërtesa "2", në kuadër të bllokut "T14", të Planit Rregullues "Tophane" dhe PZhU, gjegjësisht në parcelat kadastrale 4601-1, 4602-0, 4603-0, 4604-0, 4608-0, 4609-0, 4610-1 ZK. Prishtinë, dhe pjesë të parcelave kadastrale 4580-0 dhe 4534-0 në pronësi komunale, të trajtuara me këmbim.

**II. Lokacioni** për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Tophane", të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-579 dt. 22.11.2005, i ndryshuar me 01 nr. 35-974 dt. 03.04.2008, si dhe "Planit Urban Zhvillimor- PZhU, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013. Sipas këtij plani, kjo zonë është e destinuar "ndërtim i lartë i përzier".

Pronari me Informim nga Plani Rregullues Tophane dhe Plani Zhvillimor Urban- PZhU nr. 1235 dt. 16.11.2017, përmes sistemit online, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës, është informuar me kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit- parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - 4601-1 ZK. Prishtinë, me S=345$m^2$, me pronar Veton Topanica, tokë ndërtimore;
  - 4602-0 ZK. Prishtinë, me S=66$m^2$, Sylejmon Topanica, tokë ndërtimore;
  - 4603-0 ZK. Prishtinë, me S=101$m^2$, Ismit Shabani, Adem Berisha, tokë ndërtimore;
  - 4604-0 ZK. Prishtinë, me S=111$m^2$, Ismit Shabani, Adem Berisha, tokë ndërtimore;
  - 4608-0 ZK. Prishtinë, me S=64$m^2$, Ismit Shabani, Adem Berisha, tokë ndërtimore;



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- 4609-0 ZK. Prishtinë, me S=151m², Sylejmon Topanica, tokë ndërtimore;
- 4610-1 ZK. Prishtinë, me S=303m², Arton Topanica, tokë ndërtimore;
- Pjesë e parcelës nr. 4580-0 ZK. Prishtinë, me S=155m², P.Sh. Rrugë KK Prishtinë;
- Pjesë e parcelës nr. 4534-0 ZK. Prishtinë, me S=51m², P.Sh. Rrugë KK Prishtinë

- Të drejtat pronësore-juridike për parcelat kadastrale 4601-1, 4602-0, 4603-0, 4604-0, 4608-0, 4609-0, 4610-1 ZK. Prishtinë janë private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale, si dhe parcelat kadastrale 4580-0 dhe 4534-0 ZK. Prishtinë janë pronë shoqërore;
- Në kuadër të këtyre parcelave, ekzistojnë ndërtimet si në vijim, për të cilat para aplikimi për leje ndërtimore duhet të kërkohet leja e rrënimin në Drejtori të Urbanizmit:
  4608-0 - shtëpia individuale P+1;
  4609-0 – shtëpia individuale P+1;
  4610-1 – shtëpia individuale P+2;
  4601-1 – shtëpia individuale P+0.
- Gjithashtu, në kuadër të parcelave fqinje 4599-0 dhe 4600-0 ZK. Prishtinë, ekziston ndërtesa e banimit në bashkëpronësi- ndërtesa "1", e ndërtuar sipas "Aktvendim" 05-351-25905 dt. 18.08.2012, dhe në kuadër të parcelave kadastrale 4601-2, 4610-2, 4611-0 dhe 4612-0 ZK. Prishtinë, ekziston ndërtesa e banimit në bashkëpronësi- ndërtesa "3", e ndërtuar sipas "Aktvendim" 05-351-30074 dt. 26.11.2012;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është kryesisht i rrafshët;
- Qasja ekzistuese në parcelë kadastrale është përmes rrugëve ekzistuese "Mahir Domi" dhe "Pjetër Bogdani", gjegjësisht parcelave kadastrale 4580-0 dhe 4534-0 ZK. Prishtinë;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore dhe ndërtesa të banimit në bashkëpronësi.

IV. **Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin- ndërtimin e ndërtesës së banimit, në kuadër të Planit Rregullues Prishtina e Re- Zona Qendër në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i lokacionit – "Situacioni", bashkëngjitur këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Pjesa e parcela kadastrale e trajtuara për realizimin e ndërtesave, konkretisht pjesa e parcelës kadastrale e përfshirë- e trajtuar <u>brenda vijës rregulluese,</u> është:
  - 4601-1, me S=345m²;
  - 4602-0, me S=66m²;
  - 4603-0, me S=23m²;
  - 4608-0, me S=3m²;
  - 4609-0, me S=91m²;
  - 4610-1, me S=222m²;
  - 4534-0, me S=51m²;
  - 4580-0, me S=155m²;

  Sipërfaqe totale S=956m².
- Këmbimi i sipërfaqes së parcelave me pronësi komunale 4534-0 dhe 4580-0 S=51+155=206m², do të këmbehet me po të njejtën sipërfaqe të pjesëve të parcelave kadastrale jasht vijës rregulluese.
- Pjesa e parcelave kadastrale të trajtuara për realizimin e ndërtesës, konkretisht pjesa e parcelave kadastrale e përfshirë- e trajtuar <u>jashtë vijës rregulluese,</u> është:
  - 4603-0, me S=78m²;
  - 4604-0, me S=94m2;
  - 4608-0, me S=56m2;



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa, rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- 4609-0, me S=60m2;
- 4610-1, me S=81m2;

  Sipërfaqe totale S=369m².

  Pas këmbimit, sipërfaqja e mbetur jasht vijës rregulluese është:

  S=369-206=**163m²**.

- Me këto kushte ndërtimore, synohet rregullimi i billokut, gjegjësisht kompleksit- parcelës ndërtimore në kuadër të Planit Rregullues "Tophane", me 3 ndërtesa shumë banesore dhe afariste, ku 2 prej tyre- ndërtesa "1" dhe "3" janë ndërtuar sipas "Aktvendim" 05-351-25905 dt. 18.08.2012 dhe "Aktvendim" 05-351-30074 dt. 26.11.2012 të cilat ende nuk kanë pranim teknik, si dhe planifikohet të realizohet/ndërtohet ndërtesat shumëbanesore dhe afariste- ndërtesa "2" 2B+P+8 (sipas projekt propozimit);
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të jetë "funksion i përzier- kryesisht banim, afarizëm joshqetësues në përdhesë", si dhe me hapësira përcjellëse si kthina teknike, depo, hapësira garazhuese, etj. *(sipas projekt propozimit të prezantuar)*;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të përdhesës ose suterrenit, është max. 40% (0.4):

  **S = 956 x 0.4 = 382.40m²**

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHN), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të bodrumit, lejohet max. 60% (0.6):

  **S = 956 x 0.6 = 573.60m²**

- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe sipërfaqet gjelbëruese, ku koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, është min. 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%. Sipërfaqja gjelbëruese, duhet të arrihet për kompleksin në tërësi, gjegjësisht edhe për parcelat 4599-0, 4600-0, 4601-2, 4610-2, 4611-0, 4612-0 ZK. Prishtinë të cilat sëbashku kanë S=1984m².

  **S = (956 + 1984) x 0.4 = 1176m²** ose **S = (956 + 1984) x 0.3 = 882m² (me kulm të gjelbër)**

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) është 4.0. Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese- parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, **50%** për etazhet me vëllim mbi *51%* mbi tokë- suteren, dhe *0%* për etazhet e nëntokës- bodrume, dhe ka sipërfaqe si në vijim:

  **S = 956m² x 4.0 = 3824m²**

- Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%. Bazuar në sipërfaqen e pjesëve të parcelave kadastrale të përfshira jashtë vijës rregulluese prej S=369m², si dhe raporti i sipërfaqeve jashtë / brenda vijave rregulluese është, S=163 / 956 x 100 = 17.05%, andaj sipas këtij Vendimi, mund të kompensohet/shpronësohet sipërfaqja prej S=163m², dhe kalkulohet me koeficient ndërtimi 4.0. Pra, sipërfaqja e kompensuar do të jetë:

  **163 x 4.0 = 652m²**

  **Sipërfaqe totale: 3824 + 652 = 4476m².**

- Qasja në parcelë të jetë përmes rrugës së planifikuar, njëherit edhe ekzistuese, të paraqitur në Planin "Situacioni". Kyçja të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo;
- Për çdo njësi banimore në kuadër të ndërtesave, pa e cenuar numrin e parkingjeve të ndërtesave ekzistuese, duhet të sigurohet 1 vendparkim, kurse për hapësira afariste, gjegjësisht për çdo 30m² të neto sipërfaqes së afarizmit (hapësira afariste), të planifikohet 1 vendparkim, në kuadër të ndërtesës. Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 40% për gjelbërim apo 30% nëse ndërtohet kulmi me gjelbërim;



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Kompleksi të organizohet edhe me vendparkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotuaret, terrenet sportive, këndet e lodrave për fëmijë, etj
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për grumbullimi e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesës dhe materializimi i saj, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efiçiencës së energjisë, dhe t'i përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar, si dhe karakterit dhe kontekstit të zonës;
- Bazuar në nenin III të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, për shkaqe të shfrytëzimit efiçient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;
- Aplikimi i të gjithave kushteve dhe kritereve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret & parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër".

**V. Ndarja** / Parcelimi i parcelave kadastrale nr. 4603-0, 4604-0, 4608-0, 4609-0 dhe 4610-1 ZK.: Prishtinë, do të bëhet sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes së parcelës, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit- "zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes së parcelës, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit-"zgjidha urbane" dhe manualin e ndarjes së parcelës, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VI. Këmbimi** i pjesësve të parcelave kadastrale 4534-0 dhe 4580-0 ZK. Prishtinë, me pronësi komunale, me sipërfaqe prej 51+155=206m2, do të bëhet me po të njejtën sipërfaqe të pjesëve të parcelave 4603-0, 4604-0, 4608-0, 4609-0 dhe 4610-1 ZK. Prishtinë.

Procedura e Këmbimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve/investitorit.

**VII. Kompensimi** / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i sipërfaqes së mbetur të pjesëve të parcelave kadastrale nr. 4603-0, 4604-0, 4608-0, 4609-0 dhe 4610-1 ZK. Prishtinë, me S=163, do të bëhet sipas Vendimit 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të planifikuar për interes publik aplikohet për sipërfaqet e parcelave jashtë vijës rregulluese deri në 20%. Sipas kalkulimeve në paragrafin IV të këtij Vendimi, parcela ndërtimore është me sipërfaqe prej 2940m$^2$. Bazuar në Vendimin 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, dhe raportit të sipërfaqeve të parcelës ndërtimore dhe sipërfaqes jashtë vijës rregulluese (sipërfaqja e pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik) përcaktuar në përqindje (%) është S=163 / 956 x 100 = 17.05%. Andaj sipas Vendimit të lartcekur, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore sipërfaqja prej S= 163m$^2$. Sipas kalkulimit, sipërfaqja e kompensuar do të jetë **S=163 x 4.0 = 652m$^2$.**

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore për sipërfaqen e mbetur pas këmbimit për pjesët e parcelave kadastrale nr. 4603-0, 4604-0, 4608-0, 4609-0 dhe 4610-1 ZK. Prishtinë, bazuar në Vendimet e lartcekura. Kjo procedurë e kompensimit me sipërfaqe ndërtimore, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës.



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 4, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Sipërfaqet definitive të shpronësimit / kompensimit me sipërfaqe ndërtimore të trajtohet pas ndarjes dhe barazimit të sipërfaqeve të parcelave kadastrale sipas këtij paragrafi të këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronari & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

Procedura e kompensimit/shpronësimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore dhe pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi.

**VIII. Bashkimi** në një parcelë të vetme i pjesëve të parcelave brenda vijës rregulluese, gjegjësisht 4601-1, 4602-0, 4603-0, 4608-0, 4609-0, 4610-1, 4534-0 dhe 4580-0, si dhe parcelave 4599-0, 4600-0, 4601-2, 4610-2, 4611-0 dhe 4612-0 (sipas marrëveshjeve të vërtetuara tek organet kompetente me LRP. nr. 16709/18 dt. 24.04.2018 dhe LRP. nr. 4037/2019 dt. 13.06.2019) do të bëhet sipas parcelës ndërtimore bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit-"zgjidhja urbane", manualit të bashkimit të parcelave dhe marrëveshjeve të vërtetuara tek organet kompetente me LRP. nr. 16709/18 dt. 24.04.2018 dhe LRP. nr. 4037/2019 dt. 13.06.2019, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore dhe pas realizimi të pikës V dhe VI të këtij Vendimi, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit.

Pas krijimit të parcelës ndërtimore, mund të aplikoni në këtë Drejtori për rrënimin e ndërtesave ekzistuese të banimit individual, ku ndër të tjera, duhet të prezantoni edhe autorizimin nga pronarët e tokave për kërkesën për rrënim.

**IX. Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo Drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin- adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**X. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, "Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi ", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje fizike dhe një (1) digjitale, në këtë përmbajtje:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
